



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E  
DECENTRALIZIMIT 2010-2011  
Prishtinë, prill 2010

## Hyrje

Synimi strategjik i Qeverisë së Kosovës është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të pushtetit lokal në të gjithë territorin e Kosovës që do të sigurojë kushte të mira jetese për të gjithë qytetarët e saj duke i kushtuar kujdes përkatës nevojave të posaçme dhe brengave të komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Pas pavarësimit të Kosovës janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi ligje të reja që kanë të bëjnë me decentralizimin. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal, Ligji për Zgjedhjet Lokale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal kanë katër ligjet kyçe mbi decentralizimin. Sipas procesit të ri të decentralizimit, kompetencat e komunave janë forcuar edhe më shumë ndërsa komunat e reja janë në proces të themelimit. Zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 janë mbajtur në tri komuna të reja (Kllokot/Vërboc, Graçanicë dhe Ranillug), kurse zgjedhjet në komunën ekzistuese të Novobërdës janë mbajtur në bazë të kufijve të zgjeruar që përfshijnë 14 zona kadastrale shtesë.

Komunat e reja të Parteshit dhe Mitrovicës së Veriut janë në proces të themelimit. Ekipet Përgatitore Komunale për të dy komunat janë emëruar dhe do të punojnë për të përgatitur komunat për kohën kur do të mbahen zgjedhjet lokale dhe do të zgjidhen organet komunale.

Vazhdimi i këtij procesi kërkon një plan të ripërtërirë të veprimit që ruan një qasje ndërsektoriale të integruar për të siguruar sistemin e decentralizuar të vetëqeverisjes lokale në mbarë Kosovën. Ky Plan i Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit 2010-2011 është vazhdimësi e Planit të Veprimit 2008-2010 të miratuar nga Qeveria më 3 prill 2008, me Vendimin nr. 04/14. Është bërë një përparim i konsiderueshëm në zbatimin e Planit fillestar të Veprimit. Për t'iu përgjigjur sfidave të mbetura në zbatimin e decentralizimit, Plani i Veprimit 2010-2011 rifreskon përshkrimin e detyrave dhe kohëzgjatjen e mandatit të Grupit Ndërmintor të Decentralizimit (GND), parasheh edhe një "Grup punues për Komunat Veriore të Kosovës" dhe formalizon "Grupin Punues për Kontaktim me Publikun".

Plani i Veprimit duhet të zbatohet nga të gjitha ministrinë nën drejtimin e Grupit Ndërmintor për Decentralizim (GND) i bashkëkryesuar nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në prani të Kryeministrit.

Për të përmbushur strategjinë e decentralizimit janë identifikuar gjashtë objektiva: për të reformuar legjislacionin e pushtetit lokal, për të themeluar komunat e reja, për të bartur kompetencat dhe resurset, për të ngritur kapacitetet e komunave në koordinim me donatorët, për të zhvilluar kontakte me publikun me qëllim që t'u komunikohen dobët e decentralizimit dhe për të realizuar reformat e pushtetit lokal në komunat veriore të Kosovës.

## PËRSHKRIMI I DETYRAVE - GRUPI NDËRMINISTROR PËR DECENTRALIZIM (GND)

1. Grupi Ndërmintor për Decentralizim bashkëkryesohet nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Mbledhjet mbahen në prezencë të Kryeministrit. GND-ja përbëhet nga këto ministri:

- Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministria për Kthim dhe Komunitete
- Ministria e Administratës Publike
- Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe bashkëkryesuesit e të gjitha grupeve punuese të themeluara me këtë plan të veprimit

2. Ambasadorët e vendeve të Kuintit duhet të ftohen në mënyrë të veçantë në GND.

3. Sipas nevojës dhe me kërkesë të Kryesuesit, GND-ja themelon nën-grupe punuese për fusha të ndryshme të cilat i raportojnë GND-së.

4. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar është bashkëkryesues i të gjitha grupeve punuese.

5. Me kërkesë të Kryesuesit, GND mund të ftojë në mbledhjet e tij, përfaqësues të institucioneve qendrore, përfaqësues të zgjedhur të komunave dhe persona të tjerë që mund të ofrojnë këshilla ose që merren me çështjet që shqyrtohen. GND-ja mund të ftojë përfaqësuesit ndërkombëtarë të projekteve për ndihmesë teknike, të marrin pjesë në mbledhje si vëzhgues..

5. Grupi Ndërmintor i Decentralizimit mbledhet çdo muaj dhe ka detyrat e mëposhtme:

- Shqyrton projektligjet dhe projektvendimet e hartuara për zbatimin e decentralizimit dhe i dërgon ato për miratim në Qeveri;
- Shqyrton dhe miraton programe dhe projekte për zhvillimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit dhe konsolidimit të vetëqeverisjes lokale.
- Bashkërendon aktivitetet e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore në procesin e formimit të komunave të reja në bashkëpunim me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar dhe siguron qasje të koordinuar nga ministritë përkatëse dhe nga komunat ekzistuese;
- Vëzhgon punën e Ekipeve për Përgatitje Komunale (EPK) dhe bën vlerësimin raporteve të progresit për themelimin e komunave të reja;

- Drejton procesin e bartjes së kompetencave dhe kërkon raporte nga ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse për dinamikën e bartjes;
- Bashkërendon përpjekjet për sigurimin e burimeve të nevojshme financiare dhe burimeve të tjera për themelimin e komunave të reja;
- Bashkërendon punën e donatorëve vendorë dhe të huaj në mbështetje të këtij procesi.
- Miraton projekte dhe programe si dhe cakton prioritetet për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të të zgjedhurve dhe shërbyesve civil komunal në përputhje me nevojat që paraqiten nga procesi i decentralizimit;
- Zbaton Planin e Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit dhe dorëzon raporte periodike në Qeveri.

## **GRUPET PUNUESE TË GND-SË**

Në përputhje me objektivat e tij, GND-ja themelon grupet punuese në vijim të cilat e përkrahin zbatimin e decentralizimit në fushat e tyre përkatëse. Mandati i këtyre grupeve punuese duhet të jetë njëvjeçar dhe mund të vazhdohet nga GND-ja.

1. Grupi Punues për Reformën e Legjislacionit dhe bartjen e kompetencave
2. Grupi Punues për Themelimin e Komunave të Reja
3. Grupi Punues për Koordinimin e Donatorëve dhe Ngritjen e Kapaciteteve
4. Grupi Punues për Kontaktim me Publikun

## **OBJEKTIVI I -REFORMA E LEGJISLACIONIT TË PUSHTETIT LOKAL DHE BARTJEN E KOMPETENCAVE**

Pas hyrjes në fuqi të ligjeve që kanë të bëjnë me decentralizimin paraqitet nevoja për identifikimin, rishikimin, ndryshimin dhe ndryshimin e rregulloreve ekzistuese që prekin kompetencat komunale. Për këtë qëllim, Grupi i themeluar Punues për Reformën e Legjislacionit dhe bartjen e kompetencave ka për detyrë të shqyrtojë pajtueshmërinë e ligjeve sektoriale me ligjet themelore të vetëqeverisjes lokale dhe të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme për harmonizimin e legjislacionit dhe njëkohësisht të punojë në zhvillimin dhe implementimin e një kalendari për bartjen e kompetencave të përshkruara me legjislacionin në fuqi për organet e vetëqeverisjes lokale. Objektivi Strategjik i Qeverisë është krijimi i kushteve praktike për ushtrimin e kompetencave të decentralizuara me ligj që komunat nuk i kanë pasur më parë nëpërmjet bartjes së vazhdueshme të kompetencave si dhe resurseve të nevojshme.

### **PËRSHKRIMI I DETYRAVE - GRUPI PUNUES PËR REFORMËN E LEGJISLACIONIT DHE BARTJEN E KOMPETENCAVE (GPRLBK)**

#### **I. PËRBËRJA**

1. Përbërja e Grupit caktohet dhe mund të ndryshohet me vendim të Grupit Ndërmintor për Decentralizim(GND) me kërkesë të shumicës së anëtarëve të grupit punues.

2. GPRL-ja përbëhet nga këta anëtarë:

- Zv. Ministri i MAPL-së (bashkryesues)
- Zyra Civile Ndërkombëtare (Bashkëkryesues);
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Shërbimeve Publike;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale;
- Ministria për Kthim dhe Komunitete;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Ministria e Bujqësisë zhvillimit Rural dhe Pylltarisë,
- Përfaqësues të partive opozitës
- Përfaqësuese e shoqërisë civile,
- Agjencia Kosovar i Privatizimit

## II. Pjesëmarrësit dhe vëzhguesit e tjerë

1. Kryesuesi, pas konsultimit me anëtarët, mund të ftojë edhe përfaqësues nga institucione qendrore ose lokale që mund të ofrojnë këshillim dhe ndihmë në kryerjen e detyrave;
2. Kryesuesi, pas konsultimit me anëtarët, mund të ftojë përfaqësuesit ndërkombëtarë të projekteve për asistencë teknike dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë sipas nevojës.
3. Grupi ndihmohet nga Sekretariati Teknik i MAPL-së.

## III. Detyrat e Grupit

Grupi ka për detyrë:

1. Të identifikojë të gjitha ligjet ekzistuese që kanë ndikim mbi komunat dhe të propozojë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme për të harmonizuar të gjitha ligjet sektoriale me legjislacioni themelor (Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Kufijtë Administrativ dhe Lidhi për Financat Lokale);
2. Të propozojë ligjet e reja që janë të nevojshme për funksionimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale.
3. Të Identifikojë dhe hartojë të gjitha udhëzimet administrative që rrjedhin nga ligjet themelore dhe ligjet e tjera.
4. Të përgatisë një analizë të kompetencave që duhet të barten nga pushteti qendror në atë lokal
5. Të zhvillojë plane të veprimit për bartjen e kompetencave vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në pajtim me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligje të tjera;
6. Të përpilojë një analizë për nevojat e reja për resurse buxhetore dhe humane në përputhje me kompetencat që do të barten në përgjegjësi të autoriteteve komunale dhe harton plane të veprimit për bartjen e resurseve, pronës dhe personelit të nevojshëm për ushtrimin efektiv të kompetencave komunale.
7. Të propozojë masat dhe ndryshimet ligjore që nevojiten për të mundësuar bartjen e kompetencave dhe resurseve;

## IV. Produktet dhe oraret

1. Grupi themelohet për një periudhë njëvjeçare.

2. Grupi duhet të dorëzojë pranë GND-së inventarin e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese që lidhen me komunat, 30 ditë pas themelimit të tij;
3. Grupi shqyrton dhe përpilon ndryshimet e propozuara të legjislacionit ekzistues për harmonizimin me legjislacionin themelor për vetëqeverisje lokale dhe ia dorëzon ato GND-së brenda gjashtë muajve pas vazhdimit të këtij plani të rishikuar të veprimit;
4. Grupi shqyrton dhe plotëson projektligjet të iniciuara nga ministritë e linjës në pajtim me legjislacionin e ri për pushtetin lokal.
5. Grupi paraqet listën e udhëzimeve administrative që rrjedhin nga legjislacioni themelor dhe që ndikojnë në komuna, brenda tetë muajve pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit.
6. Grupi duhet t'ia dorëzojë GND-së planin e tij për vitin në vijim brenda dy muajve pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit;
7. Grupi e përgatitë pjesën e dytë të listës së kompetencave të cilat ende nuk janë bartur te komunat, tre muaj pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit;
8. Grupi e përgatit orarin për bartjen e kompetencave të mbetura nga pushteti qendror te komunat dhe nga komunat ekzistuese (amë) te ato të reja, gjashtë muaj pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit;
9. Grupi përgatit listën e resurseve buxhetore që duhet të barten te komunat, brenda gjashtë muajve pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit.

## **OBJEKTIVI II - THEMELIMI I KOMUNAVE TË REJA**

Objektivi strategjik i Qeverisë është riorganizimi territorial në përputhje me parimin e subsidiaritetit nëpërmjet themelimit të komunave të reja duke i kushtuar vëmendje të veçantë adresimit të brengave të komuniteteve jo-shumicë.

Përveç 30 komunave ekzistuese, të tri PNJK-të janë bërë komuna me autorizime të plota. Rishtazi, tri komuna (Klllokoti/Vërboci, Graçanica dhe Ranillugu) janë themeluar dhe komuna ekzistuese e Novobërdës është zgjeruar. Kjo e sjell numrin e komunave të Kosovës në tridhjetegjashtë (36). Plani i decentralizimit parasheh themelimin e komunave të reja të Parteshit dhe Mitrovicës së Veriut si dhe konsultime me komunitetet joshumicë me popullatë prej më shumë se 5,000 banorësh që jetojnë në një zonë të koncentruar.

Ekipet Përgatitore Komunale janë themeluar në komunat e reja të Parteshit dhe Mitrovicës së Veriut dhe po bëhen përgatitjet teknike para mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe ndihma do të vazhdojë edhe pas zgjedhjeve.

## **PËRSHKRIMI I DETYRAVE - GRUPI PUNUES PËR THEMELIMIN E KOMUNAVE TË REJA (GKR)**

### **I. PËRBËRJA**

1. Përbërja e GKR-së caktohet dhe mund të ndryshohet me vendim të GND-së me kërkesë të shumicës së anëtarëve të grupit punues.

2. Bashkëkryesues të GKR-së janë përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe ai i ICO-së;

3. GKR-ja përbëhet nga këta përfaqësues:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (Bashkëkryesuese);
- Zyra Civile Ndërkombëtare (Bashkëkryesuese);
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Shërbimeve Publike;
- Ministria e Arsimit;
- Ministria e Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministria për Kthim dhe Komunitete;



- Asociacioni i Komunave të Kosovës.

## II. PJESEMARRËSIT DHE VËZHGUESIT E TJERË

1. Kryesuesi, pas konsultimit me anëtarët, mund të ftojë edhe përfaqësues nga institucione të tjera qendrore dhe lokale që mund të ofrojnë këshillim dhe ndihmë në kryerjen e detyrave të grupit punues;
2. Bashkëkryesuesit, pas konsultimit me anëtarët, mund të ftojnë përfaqësuesit ndërkombëtarë të organizatave për zhvillim dhe ekspertë të nivelit qendror ose lokal të cilët mund të japin përkrahjen e tyre për objektivat e grupit punues.
3. GKR-ja ndihmohet nga Sekretariati Teknik i MAPL-së

## III. DETYRAT E GKR-së

GP duhet të ketë detyrat në vijim:

1. Ofron përkrahjen e tij për të siguruar funksionimin e komunave të themeluara rishtazi dhe finalizon procesin në vijim e sipër të themelimit të dy komunave të reja të Parteshit dhe Mitrovicës së Veriut;
2. Të vlerësojë nevojat buxhetore dhe të propozojë plane të veprimit në bashkëpunim me grupin për ngritjen e kapaciteteve;
3. Të propozojë veprime për rregullimet kalimtare mes komunave të reja në lidhje me pronën, objektet dhe stafin komunal;
4. Të disenjojë dhe propozojë planet operative në bashkërendim me grupin punues për bartjen e kompetencave dhe resurseve për bartjen graduale të kompetencave nga qeveria qendrore dhe komunat ekzistuese (amë) duke marrë parasysh mësimet e mësuara;
5. Të mbikëqyrë ndikimin e themelimit të komunave të reja në komunat ekzistuese lidhur me ofrimin e pandërprerë të shërbimeve publike për qytetarët;
6. Në bashkërendim me grupin punues për koordinim të donatorëve dhe ngritje të kapaciteteve, të disenjojë planin për ngritje të kapaciteteve për këshilltarët/kryetarët komunalë të posa zgjedhur dhe nëpunësit civil komunalë të posa rekrutuar;
7. Të ofrojë asistencë ligjore dhe teknike kur kërkohet.

## IV. PRODUKTET DHE ORARET

1. GKR-ja e cila fillimisht është themeluar për një periudhë dyvjeçare vazhdon punën edhe për një vit vijues;
2. GKR-ja ia dorëzon GND-së planin e vet të punës për vitin në vijim brenda dy muajve pas miratimit të planit të rishikuar të veprimit;
3. GKR-ja i paraqet në mbledhjet e GND-së (së paku çdo dy muaj) raporte mbi themelimin e komunave të reja;
4. GKR-ja duhet të dorëzojë vlerësimin e nevojave buxhetore tridhjetë (30) ditë nga miratimi i këtij plani të rishikuar të veprimit;
5. GKR-ja dorëzon planin për ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve të komunave të reja 120 ditë nga miratimi i këtij plani të rishikuar të veprimit.

## **OBJEKTIVI IV- NGRITJA DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË KOMUNAVE DHE KOORDINIMI I DONATORËVE**

Objektivi Strategjik i Qeverisë është ngritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapacitete njerëzore dhe administrative për të ushtruar përgjegjësitë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve.

Themelimi i komunave të reja, kompetencat e reja dhe sistemi i ri i financave lokale të krijuara me këto ligje do të sjellin nevojën për investim në kapacitetet infrastrukturore dhe njerëzore për krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin e kompetencave komunale si në komunat e reja ashtu edhe në ato ekzistuese.

Grupi për Ngritje të Kapaciteteve dhe Koordinim të Donatorëve duhet të punojë për zhvillimin e kapaciteteve të komunave përmes koordinimit të programeve të aftësimin të zyrtarëve komunalë dhe gjithashtu koordinon aktivitetet e donatorëve vendor dhe të huaj në komuna për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe konkurrencën e projekteve në komuna.

### **PËRSHKRIMI I DETYRAVE - GRUPI PËR NGRITJEN E KOMPETENCAVE DHE KOORDINIMIN E DONATORËVE (GNK)**

#### **I. PËRBËRJA**

1. Përbërja e GNK-së caktohet dhe mund të ndryshohet me vendim të GND-së me kërkesë të shumicës së anëtarëve të grupit punues;
2. Përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe ICO-së e bashkëkryesojnë këtë grup punues.

3. GNK-ja përbëhet nga:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (Bashkëkryesues);
- Zyra Civile Ndërkombëtare (Bashkëkryesues);
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Ekonomisë dhe Financave;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ministria e Shërbimeve Publike;
- Ministria për Kthim dhe Komunitete;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- USAID;
- Komisioni Evropian;
- DFID;
- Banka Botërore;
- Fondi Ndërkombëtar Monetar
- SIDA Suedeze
- Përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues biletateral të donatorëve tjerë

II. PJESËMARRËSIT DHE VËZHguesIT TJERË

1. GNK-ja në mbledhjet e tij mund të ftojë si vëzhgues donatorët ndërkombëtarë;
2. GNK-ja mund të ftojë edhe ministritë tjera, institucionet qeveritare ose komunale si dhe përfaqësuesit e komuniteteve për të ofruar këshilla dhe asistencë në kryerjen e punës së tij;
3. GNK-ja mund të ftojë ekspertë nga organizata ose agjenci ndërkombëtare për zhvillim të marrin pjesë në takimet e tij si vëzhgues dhe për të dhënë përkrahjen e tyre për aktivitetet e grupit punues.
4. GNK-ja ndihmohet nga Sekretariati Teknik i MAPL-së

III. Detyrat e GNK

GNK-ja ka për detyrë:

1. Të vlerësojë dhe të adresojë nevojat për ngritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve që rrjedhin nga procesin i decentralizimit me fokus të veçantë për komunat e reja;
2. Të koordinojë asistencën e donatorëve vendas dhe të huaj në infrastrukturë dhe kapacitete njerëzore;
3. Të përcaktojë prioritetet e asistencës që jepet në komuna;

4. Të zhvillojë metodologjinë për përzgjedhjen dhe vlerësimin e programeve të trajnimit dhe të hartojë module trajnimi për fushat të caktuara në bazë të nevojave;
5. Të shqyrtojë mundësinë e themelimit të një institucioni trajnues dhe ose të zhvillojë procesin e akreditimit të institucioneve trajnuese;
6. Të zhvillojë plane për trajnimin intensiv për zyrtarët e rinj komunalë;
7. Të ofrojë, në bashkëpunim me GKR-në, programet për aftësimin e shërbyesve civil të komunave të reja për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve;
8. Të mbajë diskutime të rregullta me donatorët ndërkombëtarë në fushën e ngritjes së kapaciteteve, veçanërisht në komunat e reja duke bashkëpunuar me GKR;
9. Detyra të tjera përkatëse.

#### IV. ORARI DHE PRODUKTET

1. GNK-ja e cila ishte themeluar para dy vitesh vazhdon punën edhe për një vit vijues.
2. GNK-ja duhet të dorëzojë vlerësimin e nevojave për kapacitetet infrastrukturore dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore 60 ditë pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit ;
3. GNK-ja duhet të dorëzojë metodologjinë e vlerësimit të planeve të trajnimit brenda tre muajve pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit ;
4. GNK-ja duhet të dorëzojë planin për ngritjen e kapaciteteve dhe modulet e trajnimit brenda 60 ditëve pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit;
5. GNK-ja duhet të dorëzojë planin për akreditimin e institucioneve trajnuese 90 ditë pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit ;
6. GNK-ja e dorëzon raportin e tij të aktiviteteve në mbledhjet e GND-së, së paku çdo dy muaj.

## OBJEKTIVI V - KONTAKTIMI ME PUBLIKUN RRETH DECENTRALIZIMIT

Objektivi kryesor i kontaktimit me publikun rreth decentralizimit është të informohen komunitetet e Kosovës për përparësitë e procesit të ri të reformës së vetëqeverisjes lokale në jetën e tyre të përditshme. Nevoja për të zgjeruar mandatin e grupit punues për kontaktim me publikun rreth decentralizimit i cili tanimë ekziston, është menduar që të bartë porosinë e duhur të njerëzimit rreth rëndësisë së reformës së vetëqeverisjes lokale. Grupi punues, në koordinim me grupet tjera punuese, duhet të përqendrohet në veçanti në procesin e themelimit të komunave të reja dhe t'i japë përkrahje qasjes strategjike ndaj komunave veriore të Kosovës.

### PËRSHKRIMI I DETYRAVE - GRUPI PUNUES PËR KONTAKTIM ME PUBLIKUN RRETH DECENTRALIZIMIT (GPKPD)

#### I. PËRBËRJA

1. Përbërja e GPKPD-së është si më poshtë dhe mund të ndryshohet me vendim të GND-së me kërkesën e shumicës së anëtarëve të tij
2. GPKPD-ja përbëhet prej anëtarëve të poshtëshënuar:
  - Përfaqësuesi i MAPL-së (bashkë-kryesues)
  - Përfaqësuesi i Zyrës Civile Ndërkombëtare (bashkë-kryesues)
  - Kabineti i Ministrit (MAPL)
  - Zyra për Informim Publik e MAPL-së
  - Përfaqësuesi i ZKM-së/Zyra për Informim Publik
  - Ministria për Komunitete dhe Kthim
  - Asociacioni i Komunave të Kosovës
  - Palët tjera të interesuara

#### II. PJESËMARRËSIT DHE VËZHGUESIT TJERË

1. GPKPD-ja mund të ftojë përfaqësues të Ministrive ose institucioneve tjera si dhe donatorëve nëse është e nevojshme;
2. GP-ja për Fushatën e Informimit mund të ftojë si ekspertë vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë në takimet e tij dhe të kërkojë këshillat e tyre për kryerjen e punëve të grupit.
3. GPKPD-ja do të përkrahët nga Sekretariati Teknik i MAPL-së

#### III. DETYRAT E GPKPD-SË

GPKPD-ja ka për detyrë:

1. Të hartojë planin e hollësishëm të detyrave të tij brenda dy muajve pas miratimit të këtij plani të rishikuar të veprimit nga ana e GND-së.
2. Të identifikojë grupet brenda shoqërisë për kryerjen e aktiviteteve të kontaktimit të publikut për procesin e decentralizimit;
3. Të hartojë konceptet për spotet televizive, billboardet dhe fletëpalosjet që do të shpërndahen
4. Organizojë debate dhe tryeza të rrumbullakëta me struktura të ndryshme të shoqërisë në Prishtinë dhe qytete tjera
5. Bashkërendojë punën me grupet tjera punuese sa i përket nevojës dhe elementeve që duhet t'i paraqitet publikut;
6. Mbikëqyrë, kontrollojë dhe raportojë ecurinë e Kontaktimit të Publikut sa i përket decentralizimit.

#### IV. ORARI DHE PRODUKTET

1. GPKPD-ja do të vazhdojë punën për një vit;
2. GNK-ja e dorëzon raportin e tij të aktiviteteve në mbledhjet e GND-së, së paku çdo dy muaj;
3. GPKPD-ja do t'i dorëzojë raportet e përgjithshme për aktivitetet e saj GND-së para fundit të mandatit të saj.